

KONTRATË SOCIALE PARAPRAKE
(Dokumenti prezantues me Partite Politike)

Në _____, sot më datë _____, 2017, palët e mëposhtme:

1. **Organizata Epoka e Re** me seli ne Fier, perfaqesuar nga Nevila Jahaj , në cilësinë e përfaqësueses se aktivistëve dhe grupit të Komisionit Keshillimor Mallakastër, sic përshkruhet më mirë në **Aneksin A** të kësaj Kontrate, (ne vijim referuar si **“Organizata”**);

dhe

2. **Znj./Z.** _____, shtetas shqiptar, me banim në adresën _____, në cilësinë e Kandidates/Kandidatit të Partisë _____, ose Koalicionit _____, për kandidat për deputete ne Kuvendin e Shqiperisë për zgjedhjet 2017, (ne vijim referuar si **“Kandidatja/Kandidati”**);

bien dakort të lidhin një Kontratë Sociale sipas kushteve dhe termave si vijon:

KUSHTE PARAPRAKE

1. Organizata në kuadër të projektit **“Komisioni Keshillimor Mallakastër – Te Rinjtë Veprojnë”**, mbështetur nga Lëviz Albania, nëpërmjet kontributit financiar të Qeverisë së Zvicerane, ka organizuar në Bashkinë Mallakastër, një seri aktivitete me të rinj për të identifikuar dhe përzgjedhur nevojat dhe prioritetet me fokus rininë/të drejtat e grave/të drejtat e komunitetit/, të cilat synon t’ia adresojë Kandidates/Kandidatit me qëllim përfshirjen e tyre në politikën, planet dhe buxhetet qendrore dhe plotësimin e tyre gjatë mandatit përkatës, nëse Kandidatja/Kandidati do të jetë fitues në Zgjedhjet Qendrore 2017.
2. Prioritetet e mësipërme janë pranuar nga një numër i konsiderueshëm qytetarësh në Bashkinë e Mallakastër të cilët kanë nënshkruar dokumentin e prioriteteve, që i bashkëngjitet kësaj Kontrate Sociale si Aneks A dhe përbën pjesë thelbësore të saj.
3. Kandidatja/Kandidati garon si përfaqësues i Partisë _____ ose Koalicionit _____ për Deputete ne Kuvendin e Shqiperisë në kuadër të Zgjedhjeve Qendrore 2017.
4. Partia _____ dhe Kandidatja/Kandidati ----- ka shprehur angazhimin e saj/tij për zbatimin e prioriteteve apo ndikimin sipas rolit të saj/tij në qeverisjen apo këshillin vendor gjatë periudhës së ushtrimit të mandatit të saj/tij për plotësimin e kërkesave të qytetarëve.

Për sa më sipër Palët bien dakort si vijon:

Neni 1 - Qëllimi i Kontratës

Palët e kësaj Kontrate angazhohen të krijojnë një marrëdhënie bashkëpunimi për adresimin dhe plotësimin e prioriteve të qytetarëve, që përshkruhen në Aneksin A të kësaj Kontrate dhe që në mënyrë të përmbledhur janë:

Prioritetet:

- 1-Infrastruktura në përgjithësi, me fokus zhvillimin, zgjerimin e qytetit dhe ajo rrugore në vecanti, kryesisht në zonat rurale.
- 2- Hapja e një shkolle profesionale, me degë që lidhen me tipologjinë ezonës, e cila do të siguronte profesionistë të aftë për t'u punësuar në frontet e punës brenda zonës.
- 3- Ngritja e një spitali, për të siguruar kushtet e nevojshme, shtimin e mjekëve dhe shërbimeve.
- 4- Ndryshimi i ligjit të sigurimeve shoqërore për fermerët e zonës së Mallakastrës.
- 5- Ndërtimi i një parku për qytetin që do të shërbente si vend shlodhjeje, argëtimi dhe zbutje të ndotjes së ajrit të zonës.
- 6- Buxhet të dedikuar për të rinjtë dhe hapjen e një qendre rinore në nivel lokal, që do të nxiste aktivizimin rinor.

Neni 2 – Premtimet e Kandidates / Kandidatit

Nëse do të rezultojë fituese/fitues në Zgjedhjet për kuvendin e Shqipërisë, Kandidatja/Kandidati zotohet të punojë për zbatimin e prioritetëve që paraqiten në Aneksin A dhe nenin 1 të kësaj Kontrate, apo të ndikojë sipas rolit të saj/tij në qeverisjen apo këshillin vendor gjatë periudhës së ushtrimit të mandatit të saj/tij për plotësimin e tyre.

Kandidatja/Kandidati angazhohet të adresojë prioritetet sipas Aneksit A, në politikat, planet dhe buxhetet vendore gjatë ushtrimit të mandatit të tij, deri në zgjidhjen e plotë të tyre, sipas kushteve dhe termave të parashikuara në këtë Kontratë Sociale.

Neni 3 – Afatet kohore

Kjo Kontratë Sociale lidhet pa afat. Kandidatja/Kandidati angazhohet të punojë për zgjidhjen e prioritetëve të listuara në Aneksin A si më poshte:

Prioriteti 1 – Deri më datë _____

Prioriteti 2 – Deri më datë _____

Neni 4 – Forma e bashkëpunimit midis Palëve të Kontratës Sociale

Bashkëpunimi nëpërmjet kësaj Kontrate realizohet nëpërmjet:

Organizata angazhohet të qartësojë prioritetet për Kandidaten/Kandidatin dhe të lehtësojë takimet midis saj/tij dhe grupeve të interesit duke ndikuar në krijimin e një dialogu të përhershëm e të qëndrueshëm midis qeverisësve lokalë dhe komunitetit.

Kandidatja/Kandidati angazhohen të zbatojnë në mënyrë permanente mjete për përfshirjen e qytetarëve në çdo vendimarrje, proces dialogu apo konsultimi publik, që ka lidhje apo ndikon për zbatimin e prioriteteve që përshkruhen në Aneksin A të kësaj Kontrate. Për këtë arsye, Kandidatja/Kandidati premtan se është i gatshëm të bashkëpunojë në mënyrë të vazhdueshme me Organizatën dhe organet e saj për të rritur transparencën dhe eficensën e zbatimit të saj.

Neni 4 – Monitorimi i Kontratës Sociale

Palët bien dakort se Organizata dhe strukturat e saj do të kryejnë aktivitete për monitorimin e premtimeve të marra përsipër nga Kandidatja/Kandidati nëpërmjet kësaj Kontrate Sociale.

Kandidatja/Kandidati angazhohet të plotësojë totalisht premtimet e marra përsipër me anë të kësaj Kontrate Sociale. Megjithatë, palët e kësaj Kontrate janë të vetëdijshme për faktin se për shkak të problematikës dhe pengesave të parashikuara dhe/ose atyre të paparashikuara, premtimet e Kandidates/Kandidatit mund edhe të mos përmbushen totalisht, por Kandidatja/Kandidati angazhohet të veprojë në përputhje me parimet e transparencës dhe përgjegjshmërisë sipas parashikimeve të K.Pr.Administrative, për të informuar në mënyrë periodike dhe të detajuar Organizatën dhe grupet e interesit, nëpërmjet takimeve direkte, debateve publike apo mbledhjeve me komunitete të ndryshme, për çdo problem, sfidë, ngjarje apo fakt që ndikon në përmbushjen e qëllimeve të kësaj Kontrate.

Kandidatja/Kandidati pranon që veprimtaria e saj/tij, gjatë përmbushjes së qëllimeve të kësaj marrëveshje të jetë objekt monitorimi nga ana e Organizatës, e cila ka të drejtë të hartojë raportet përkatëse dhe t'i bëjë ato publike, përfshi këtu rrjetet sociale, median apo shtypin.

Neni 5 – Komunikimi midis Palëve

Palët e kësaj Kontrate angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë cdo informacion të nevojshëm për realizimin e zbatimit të saj.

Neni 6 – Natyra e Kontratës dhe hyrja në fuqi

Palët e kësaj Kontrate Sociale bien dakort që ky akt përfaqëson një dokument në bazë vullneti dhe nuk përbën një akt të detyrueshëm ligjor.

Natyrë e Kontratës Sociale ka në themel të saj përgjegjshmërinë politike, administrative dhe morale të Kandidatës/Kandidatit ndaj premtimeve dhënë qytetarëve të Bashkisë Mallakastër, në bazë të kësaj Kontrate.

Për efekt të transparencës, Organizata ka të drejtë që kopje të kësaj Kontrate ta publikojë në rrjetet sociale, media, shtyp etj..

Kjo Kontratë nënshkruhet në dy kopje origjinale, nga një për secilën palë dhe hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj prej palëve.

Nënshkrimi i Kandidates/Kandidatit

Datë

Nënshkrimi i përfaqësuesit të Organizatës

Datë